



DualAFS - Programi i studimeve të integruara me punë praktike në bujqësi dhe sigurinë ushqimore

Programi i BE-së:	Erasmus +
Nënprogrami:	Bashkëpunimi për inovacionin dhe shkëmbimin e praktikave të mira
Masa KA2:	Ndërtimi i Kapaciteteve në Arsimin e lartë
Kohëzgjatja:	(CBHE) 15.01.2021 - 14.01.2024

E-Newsletter Numër 3, Korik 2022

DualAFS: Universiti “Isa Boletini” i Mitrovicës, organizoi konferencën e dytë ndërkombëtare, në kuadër të projektit DualAFS

Konferenca në kuadër të “Seminarit 2-të Ndërkombëtar”, Kurrikulat e dyfishta – Projekti Studimi dhe Praktika e Punës në Bujqësi dhe Siguria Ushqimore, u mbajt më 3 mars 2022, në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM). Pjesëmarrës në këtë projekt, përveç atyre nga Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore në UIBM, janë edhe përfaqësues të universiteteve partnere në këtë projekt: Universiteti “Nuertingen-Geiingen” nga Gjermania, i cili është partner lider; Universiteti “Savonia” nga Finlanda; Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Universiteti “Fan S. Noli” i Korçës, nga Shqipëria, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Në hapje të Seminarit, Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Kërkim Shkencor, Prof. Dr. Behxhet Shala, u uroi suksese pjesëmarrësve të Seminarit. Ai tha se UIBM po zhvillon politika dhe mekanizma për të avancuar mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, duke përfshirë nxitjen e bashkëpunimit me partnerë të ndryshëm vendas dhe ndërkombëtarë.

Sipas tij, përpjekja shtron nevojën për përshtatjen e kurrikulave që të jenë sa më produktive dhe të zbatueshme. “Ky projekt është një nga ato thelbësore në arritjen e këtij objekti, në këtë rast, në fushën e bujqësisë dhe sigurisë ushqimore”, tha ai.

Në konferencë u paraqitën rezultatet e një ankete të realizuar në Kosovë dhe Shqipëri me biznese ushqimore, fermerë, studentë, staf akademik dhe institucione publike. Gjatë konferencës, u diskutua për rëndësinë e bizneseve si partnerë të universiteteve për mësimin praktik dhe trajnimin e studentëve. Në konferencë, u diskutua edhe për qendrat e të mësuarit gjatë gjithë jetës, që do të krijohen brenda universiteteve.

Më 2 Mars 2022, Seminari vazhdoi punimet rreth kurrikulave të orientuara nga praktika në universitetet partnere nga Shqipëria dhe Kosova. Kurrikula të dyfishta janë zhvilluar në Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe Universitetin “Fan Noli” Korçë, ndërsa Universiteti “Isa Boletini” Mitrovicë dhe Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” kanë avancuar pjesën praktike të kurrikulave aktuale.

Në ditën e tretë dhe të fundit të “2nd International Workshop” në kuadër të projektit DualAFS, që u mbajt në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë, pjesëmarrësit vizituan verarinë “Stone Castle” në Rahovec. Në këtë vizitë studimore u vizituan laboratorit, procesi i filtrimit dhe linja teknologjike e mbushjes dhe paketimit të verës. Për historikun, procesin e prodhimit, eksportin dhe investimet që janë bërë në kompani, pjesëmarrësve u foli inxhinieri, Fejzullah Berisha.

Ndryshe, projekti “DualAFS” synon zhvillimin e njohurive të studentëve dhe punësimin e të diplomuarve, po ashtu përmirësimin e konkurrencës në shkencat e bujqësisë dhe blegtorisë, përpunimit të ushqimit dhe përmirësimin e konkurrencës së bizneseve dhe përfituesve të tjerë në bujqësi e blegtori dhe cilësinë e sigurinë e produkteve ushqimore me prejardhje shtazore.



Figur1 1: Pjesëmarrësit e Seminarit të dytë ndërkombëtar në UIMB

DualAFS Infrastrukturë moderne dixhitale dhe metodologji bashkëkohore për mësimdhënie (e- Learning), UBT

Universiteti Bujqësor i Tiranës siguron infrastrukturë moderne dixhitale dhe metodologji bashkëkohore për mësimdhënie (e- Learning), kërkim shkencor dhe trajnime në fushën e Zooteknisë.

Në kuadër të projektit Erasmus+ “Studimet universitare Duale në zootekni, agrobiznes dhe siguri e produkteve blegtorale“, Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) ka krijuar një infrastrukturë moderne dixhitale dhe po aplikon metodologji bashkëkohore për mësimin online (e-Learning) në Departamentin e Shkencave Zooteknike. Dy auditore, të pajisura me kompjutera dhe modulet Hybrid, kanë krijuar mundësi që studentët të ndjekin лекsione dhe mësimet të tjera edhe nga profesorë të huaj, jo vetëm të universiteteve partnere në këtë projekt (Universiteti Nürtingen -Gjermani, Universiteti Savonia – Finlandë), por edhe të universiteteve të tjera të Europës dhe më gjërë. Tre auditorë të pajisur me kompjutera do të përdoren për ushtrime dhe seminare me studentët e këtij departamenti dhe të fakulteteve e departamenteve të tjera të UBT. Kjo infrastrukturë moderne do të përdoret gjithësisht edhe për kurset e trajnimit që do të afrojnë UBT, përkatësisht ky departament, për specialistët e zooteknisë që punojnë në Shërbimin Këshillimor për blegtorinë si dhe ata që drejtojnë fermat blegtorale në vendin tonë.



Figura 2: Ceremonia e inagurimit të infrastrukturës së re IT në Departamentin e Shkencave Zooteknike, UBT

Aplikimi i e-Learning në mësimdhënie dhe në kurset e trajnimit mbështetet në metodat më të përparuara didaktike që zbatojnë universitetet e huaja, sidomos ato partnere të këtij projekti, Universiteti Savonia në Finlandë dhe Universiteti Nürtingen Geislingen në Gjermani. Profesorë të universiteteve partnere po trainojnë edhe pedagogët e UBT edhe për aplikimin e metodave bashkëkohore didaktike në mësimin në distancë, sidomos e-Learning. Module të zhvilluara të

universiteteve partnere për studentët e cikleve Bachelor dhe Master po përshtaten nga Departamenti i Shkencave Zooteknike të UBT dhe do t'u afrohen studentëve që ndjekin programet Bachelor dhe Master në fushën e Zooteknisë si dhe do të përfshihen në kurset e trajnimit të specialistëve të sektorit të blegtorisë dhe drejtuesve të fermave blegtorale në vendin tonë.

DualAFS Takimi në Finlandë – Përfitimi nga shembulli i Universitetit të Shkencave të Aplikuara, Savonia

Anëtarët e konsorciumit të projektit u takuan në Iisalmi, Finlandë, në periudhën 20-25 Mars 2022, në Universitetin e Shkencave të Aplikuara, Savonia për të diskutuar hapat në vijim të projektit dhe për të shkëmbyer ide të vlefshme rreth zbatimit të fazave praktike të trajnimit në studime dhe përdorimin e teknologjive të e-learning në mësimdhënien e përditshme.

Gjatë 5 ditëve, konsorciumi i projektit u prit nga stafi i Universitetit të Shkencave të Aplikuara Savonia. Dita e parë iu kushtua shpërndarjes së rezultateve të “Studimit Bazë” të kryer nga projekti, i cili, ndër të tjera, shqyrton opinionet e palëve të interesuara nga sektorët publikë dhe privatë mbi temën e mësimdhënies së orientuar nga praktika në universitete. Përfundime të rëndësishme kishin të bënin me faktin se punëdhënësit e mundshëm në sektorin bujqësor në Shqipëri/Kosovë dëshirojnë që të diplomuarit të kenë aftësi të mira IT, në gjuhë të huaja dhe aftësi praktike. Këto kërkesa mund të përmbushen shumë mirë në projektin DualAFS nëpërmjet lëvizshmërisë së studentëve, trajnimeve të stafit, bashkëpunimit të universiteteve dhe partnerëve të praktikës, si dhe bashkëpunimit të ngushtë me partnerët evropianë (Savonia/NGU).



Figura 3: Prezantimi i studimeve praktike në Savonia nga staffi i këtij universiteti, si dhe diskutime midis pjeshtarëve në grupe, se si mund të përmirësohen arritjet e projektit.

Një pjesë e rëndësishme e takimit të komitetit drejtues, ishte vetë-vlerësimi i veprimtarive të kryera të projektit. Një shqyrtim i tillë bëhet rregullisht dhe udhëhiqet nga ekspertë nga partnerët evropianë (Savonia/NGU). Qëllimi është të nxisë pikat e forta të bashkëpunimit të projektit, por edhe të identifikojë vështirësitë që mund të trajtohen dhe të përmirësohen në periudhën e ndjekjes. Një administrim i tillë cilësor mundëson që objektivat e përcaktuara të arrihen me efektshmëri.



Figura 4: Pjesëmarësit e projektit gjatë ditës së ekskursionit — Ponsse, Vieremä, Finland

DualAFS Lëvizjet e stafit akademik nga Universiteti i Prishtinës, Kosovë në Universitetin Savonia, Finlandë

Universiteti i Shkencave të Aplikuara, Savonia, Finlandë, organizoi lëvizjet me synim trainimin e stafit akademik në periudhën 21 Mars deri 2 Prill 2022. Kjo lëvizje u organizua sipas planifikimit të aktiviteteve të projektit.

Gjatë vizitës në UAS Savonia, stafi akademik nga Universiteti “Hasan Prishtina”, Kosovë pati mundësinë të vizitojë institucione të ndryshme dhe të takohet me kolegë nga fushat e tyre respective të studimit.



Figura 6. Aktivitetet e kryera në Universitetin Savonia, Finlandë

Eksperienca e përftuar në aspektin e punës praktike të studentëve, si dhe lidhjet me fermat dhe bizneset me Universitetin e Savonias ishin mjaft të mira. U realizuan vizita në shkollat profesionale, që përgatisin student për UAS Savonia, gjë që i mundëson studentët të orientohen më shumë drejt praktikës, si dhe të gjenë punë më me lehtësi.

Shumica e fermave që ata vizituan, menaxhoheshin nga studentë të diplomuar në UAS Savonia dhe një pjesë e tyre ndiqnin kurse të vazhduara, për të fituar njohuri të reja në fushën e tyre.

U realizuan takime të rëndësishme me kolegë të fushave të afërta, ku u diskutuan metodat e mësimdhënies, që aplikohen në UAS.



Figura 7. Aktivitete trainuese në Universitetin Savonia

Ata diskutuan mbi përmbajtjen e syllabuseve me theks specifik mbi pjesën praktike që studentët kanë për të kryer në ferma dhe biznese të ndryshme. Për këtë arsye, ata morën pjesë në лекsione, por gjithashtu edhe mbajtën vetë лекsione për të shkëmbyer eksperiencën në mësimdhënie.

Në lidhje me mësimin, një aspekt i rëndësishëm ishte praktika e e-learning. Bashkërisht me studentët dhe kolegët ata vizituan disa fermerë ku patën mundësinë të diskutonin mbi mënyrat e prodhimit dhe menaxhimit të fermave, por gjithashtu mbi përfshirjen e studentëve në pjesën praktike. Së fundmi, vlen të theksohet se ishte një kënaqësi e veçantë mënyra e zhvillimit të “trainimit”, e cila do të bëhet më tërheqëse në punën e tyre në të ardhmen.

Një kënaqësi e veçantë ishte të mësoje mbi historinë dhe kulturën finlandeze (Fig 8).



Figura 8. Kohë e lirë në Universitetin e Savonias

Në të ardhmen e afërt brenda projektit do të realizohen aktivitete të tjera, të tilla si trainimi i stafit akademik nga universitetet e Shqipërisë dhe Kosovës në NGU si dhe mbi shkëmbimet e studentëve midis IAL-ve

DualAFS Lëvizjet e stafit akademik nga Universiteti “Fan Noli” Korçë, drejt Universitetit Nuertingen – Geislingen, Stuttgart, Gjermani

Në kuadër projektit DualAFS, më 15 Maj 2022, Universiteti Nuertingen-Geislingen”, priti për trajnim dhe shkëmbim experience dy lektorët e Universitetit “Fan S. Noli” Korçë.

- Dr. Dorjan Marku realizoi mobilitetin në periudhën 15 – 28 Maj 2022, për krijimin e programit të modulit ”Menaxhimi i Zinxhirrit të Vlerës”, i cili do të integrohet në kurrikulën e programit të studimit “Bachelor në Menaxhim Agrobiznesi” pranë Fakultetit të Bujqësisë. Përfshirja e menaxhimit të cilësisë në zinxhirin ushqimor dhe aplikimi i qasjeve praktike, projekteve dhe rasteve studimore ishin fokusi i trajnimit dhe bashkëpunimit me Prof. Heinrich Schüle and Prof. Juergen Braun.
- Gjatë periudhës së mobilitetit, ai takoi dhe bashkëpunoi me partnerë të praktikës në punë (përfaqësues të kompanive) të Universitetit “Nuertingen – Geislingen”, dhe përftoi njohuri mbi mënyrën si grupet e interes me njohuri praktike mund të përfshihen në programet e studimit.



- Dr. Aldona Minga, ishte pjesë e mobilitetit të realizuar në Universitetin “Nuertingen – Geislingen”, për periudhën 15 – 28 Maj 2022, për krijimin e syllabusit të modulit “Drejtimit Financiar”. Krijimi i një moduli sa më aplikativ dhe i përshtatur ndaj nevojave të tregut të punës ishin fokusi i bashkëpunimit të saj me Prof. Fischer.
- Gjithashtu, ajo u njoh me rëndësinë që ka inovacioni për kompanitë, njohuritë praktike, mënyrat e promovimit të gjetjeve inovative dhe rolin që duhet të ketë universiteti.



Partnerët e projektit dhe kontaktet

Universiteti Nuertingen-Geislingen, Gjermani	Prof. Dr. Heinrich Schuele	heinrich.schuele@hfwu.de
Savonia, Universiteti i Shkencave të Aplikuara, Finlandë	Dr. Ardita Jahja-Hoxha	Ardita.hoxha-jahja@savvonia.fi
Universiteti Bujqësor i Tiranës, Shqipëri	Prof. Dr. Anila Hoda	ahoda@ubt.edu.al
Universiteti “Fan Noli” Korçë, Shqipëri	Prof. Dr. Gjergji Mero	gmero@unkorce.edu.al
Universiteti i Prishtinës, Kosovë	Prof. Dr. Skender Muji	skender.muji@uni-pr.edu
Universiteti “Isa Boletini” i Mitrovicës, Kosovë	Dr. Arber Hyseni	bahtir.hyseni@umib.net
Qendra e Zhvillimit Blegtoral dhe Rural, Shqipëri	Prof. Dr. Gori Stefi	gori.stefi@gmail.com
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Kosovë	Kujtim Uka	kujtim.uka@rks-gov.net
Shoqata e Prodhuesve të	Gente Kadriu	kadriugenta@gmail.com

Qumështit, Kosovë

**Qendra e Transferimit të
Teknologjive Bujqësore,
Korçë, Shqipëri**

Eleni Elefteriu

**Agjencia e Sigurimit
të Cilësisë në
Arsimin e Lartë në
Shqipëri**

Dr. Xhiliola Bixheku

xhiliola.bixheku@ascal.al

**Shoqata AGRINET,
Shqipëri**

Tomi Pikuli

tomi_pikuli@yahoo.com

Nucleus Shqipëri

Valbona Paluka

valbona.paluka@nucleus.al

Text & Layout

Myqerem Tafaj and Anila Hoda,
Agricultural University of Tirana

Johannes Munz,
Nuertingen-Geislingen
University

Alltane Kryeziu, University
"Hasan Prishtina", Prishtina

© 2020-2024, DualAFS.

All rights reserved.

Pictures

© University "Isa Boletini" of Mitrovica,
Kosovo

© Agricultural University of Tirana,
Albania

© Savonia University, Finland